



U skladu sa ovlašćenjima datim članovima 64, 107, 108, 109 Zakona Br.03/L-073, o Opštim izborima u Republici Kosovo, na osnovu odluke Predsednika Republike Kosovo dana 07.01.2021, Br.09/2021, o raspisivanju prevremenih izbora za Skupštinu Kosova, Centralna izborna komisija na redovnom sastanku održanom 08.01.2021, donosi:

ODLUKA

O usvajanju Strategije Javnog Informisanja za Prevremene Izbore za Skupštinu Kosova

- I. Usvaja se strategija Javnog Informisanje za prevremene izbore za Skupštinu Kosova koji će se održati 14.02.2021.
- II. Strategija Javnog Informisanja je sastavni deo ove odluke.
- III. Obavezuje se Nadzorni Odbor CIK-a za sprovođenje Strategije.
- IV. Ova odluka stupa na snagu danom potpisivanja iste.

Priština, 08.01.2021

Predsednica Centralne izborne komisije



Valeete Daka



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

**STRATEGJIA E INFORMIMIT PUBLIK PËR ZGJEDHJET E PARAKOHSHME PËR
KUVENDIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

14 SHKURT 2021

Prishtinë janar 2021

Përmbajtja

Hyrje	3
Qëllimi i Strategjisë	4
Objektivat e Strategjisë	4
Trendët e Zgjedhjeve për Kuvend të Kosovës të vitit 2010, 2014, 2017 dhe 2019	5
Parimet e Strategjisë	6
Qasja e Informimit Publik	7
Grupet e Synuara	7
Produktet për Informim Publik	9
Mjetet e Komunikimit	10
Periudhat e Procesit Zgjedhor	12
Bashkëpunimi me Palët e Interesit	14
Struktura e Menaxhimit dhe Mënyrat e Zbatimit	15
Buxheti për Realizimin e Strategjisë	15
Shtojca nr. 1. Plani i veprimit për zbatimin e strategjisë së IP-së	16
Shtojca nr. 2. Tabela me sasitë e produkteve dhe specifikat	33

Hyrje

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) është organ i përhershëm që përgatitë, mbikëqyrë, drejton dhe verifikon të gjitha aktivitetet që kanë të bëjnë me procesin e zgjedhjeve, referendumet dhe shpall rezultatet e tyre¹.

Me qëllim të përmbushjes së këtyre parimeve kushtetuese dhe ligjore, KQZ-ja, dhe Sekretariati i KQZ-së, ndërmarrin aktivitete për edukimin e votuesve me qëllim të rritjes së aftësive të votuesve për procedurat e votimit dhe procedurat e mbrojtjes së të drejtave zgjedhore².

Strategjia e informimit publik për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës më 14 shkurt 2021, është një dokument i cili i përmbledh të gjitha aktivitetet për secilën nga periudhat e procesit zgjedhor duke përfshirë bashkëpunimin me institucionet e ndryshme për të dërguar mesazhet e nevojshme tek secili votues dhe palët e interesit përmes mjeteve të ndryshme të komunikimit që të arrihet një proces i suksesshëm zgjedhor.

Për hartimin e kësaj strategjie është marrë për bazë përvoja nga vitet e kaluara dhe nga rekomandimet e dala nga analizat dhe raportet e hulumtimeve³ të ndryshme për proceset e kaluara zgjedhore dhe nevoja për informimin dhe edukimin për të gjithë qytetarët me të drejtë vote, pavarësisht moshës, gjinisë, vendbanimit dhe nacionalitetit.

Strategjia ka për qëllim që të informojë qytetarët me të drejtë vote për të shfrytëzuar të drejtën e tyre për votim, mënyrën, kohën dhe vendin për votim, si dhe identifikimin e grupeve të synuara, bashkëpunimin me palët e interesit, përcjellja e informacioneve mbështetëse tek mediat, subjektet politike dhe vëzhguesit përgjatë gjithë procesit zgjedhore.

Kjo Strategji bënë që KQZ-ja, të perceptohet si institucion kompetent dhe transparent në respektimin e parimeve kushtetuese, ligjore dhe atyre ndërkombëtare në administrimin e zgjedhjeve të lira dhe demokratike.

¹ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 139

² Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Neni 2

³ <https://www.kqz-ks.org/hulumtime-dhe-analiza/>

Qëllimi i Strategjisë

Qëllimi i përgjithshëm i fushatës së informimit publik, është t'i informoj votuesit rreth procesit zgjedhor, funksionimit të procesit dhe të drejtave të tyre sipas Kushtetutës së Kosovës dhe Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme.

Fushata, do të jetë gjithashtu e projektuar dhe do të zbatohet për të mbështetur përgjegjësitë dhe veprimtaritë specifike të KQZ-së, të përcaktuara në Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme (siç është periudha e shërbimit votues, konfirmimi dhe kundërshtimi i listës votuese, votuesit me nevoja dhe rrethana të veçanta, procedurat e votimit, votimi jashtë Kosovës).

Kjo strategji është përgatitur që KQZ-ja, ti përmbush obligimet që ka për informimin e votuesve gjatë të gjitha periudhave të procesit zgjedhor.

Përveç informimit të votuesve, KQZ-ja, gjithashtu është përgjegjëse edhe për informimin e palëve tjera të interesit për zgjedhje sikurse subjektet politike, organizatat e shoqërisë civile dhe mediat lidhur me aktivitetet zgjedhore në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe në kohën e duhur.

Strategjia e Informimit Publik për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës më 14 shkurt 2021, përqendrohet në dy nevoja të rëndësishme:

- Informimi i të gjithë qytetarëve të Kosovës për procesin dhe procedurat zgjedhore; dhe
- Dhënia e informimit të saktë dhe me kohë votuesve dhe palëve të interesit dhe në gjuhët e tyre.

Realizimi i fushatës së Informimit Publik, duhet të koordinohet në përmbajtje dhe në kohë me të gjitha aktivitetet zgjedhore siç do të përcaktohen me planin operacional.

Objektivat e Strategjisë

Objektivat e strategjisë së informimit publik për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës më 14 shkurt 2021 janë si në vijim:

- Informimi i votuesve dhe palëve të interesit për procesin zgjedhor;
- Informimi dhe edukimi i votuesve për rëndësinë e votës;
- Zvogëlimi i numrit të fletëvotimeve të pavlefshme
- Ngritja e vetëdijes se votuesve për rëndësinë e pjesëmarrjes në zgjedhje; dhe
- Informimi i votuesve për mënyrat e denoncimit të keqpërdorimit të votës.

Trendët e Zgjedhjeve për Kuvend të Kosovës të vitit 2010, 2014, 2017 dhe 2019

Nga tabela në vijim shihet se trendi i pjesëmarrjes në zgjedhje ka ndryshuar nga zgjedhjet në zgjedhjet e radhës me një lëvizje rreth 2% deri në 3% .

Zgjedhjet	Nr. i votuesve të regjistruar	Nr. i votuesve që kanë votuar	% e pjesëmarrjes
Zgjedhjet për Kuvend të Kosovës 2010	1,632,279	739,439	45.29%
Zgjedhjet për Kuvend të Kosovës 2014	1,799,023	766,847	43.63%
Zgjedhjet për Kuvend të Kosovës 2017	1,888,059	779,729	41.30%
Zgjedhjet për Kuvend të Kosovës 2019	1,961,213	873,951	44.56%

Fletëvotimet e pavlefshme për Zgjedhjet për Kuvend të Kosovës në vitet 2010, 2014, 2017 dhe 2019

Siç shihet në grafikun më poshtë, për zgjedhjet për Kuvend të Kosovës, numri i fletëvotimeve të pavlefshme nga viti 2010 kishte një rritje të vogël në zgjedhjet e vitit 2014 dhe 2017, ndërsa në zgjedhjet e viti 2019 kishte një zvogëlim të konsiderueshëm në krahasim me vitin 2017. Nga të dhënat e fletëvotimeve të pavlefshme në këto katër palë zgjedhje, lind nevoja që në Zgjedhjet e parakohshme të 14 shkurtit 2021, informimi i votuesve ende duhet të fokusohet në mënyrën e plotësimit të fletëvotimit me qëllim të zvogëlimin të fletëvotimeve të pavlefshme edhe më tutje.




Figura nr. 1. % e numrit të fletëvotimeve të pavlefshme për Zgjedhjet për Kuvend të Kosovës 2010, 2014, 2017 dhe 2019

Parimet e Strategjisë

Kjo strategjia është e bazuar në pesë parime themelore, si me poshtë:

○ **Parimi i gjithëpërfshirjes**

Parimi i gjithëpërfshirjes ka për qëllim informimin për të gjithë qytetarët me të drejtë vote, pavarësisht moshës, gjinisë, vendbanimit dhe nacionalitetit. Kjo synohet të arrihet përmes të gjitha llojeve të mjeteve të komunikimit dhe informimit. Po ashtu, kërkohet angazhimi i të gjitha kontakteve me publikun e gjerë dhe me institucionet relevante. E gjithë kjo do të arrihet duke u bazuar në përvojën nga vitet e kaluara dhe nga rekomandimet e dala nga analizat dhe raportet e hulumtimeve të ndryshme për proceset e kaluara zgjedhore.

○ **Parimi i thjeshtësisë së materialeve**

Të gjitha materialet, audiot, audiot vizuale dhe materialet e shtypura, duhet të kenë përmbajtje të thjeshtë, në mënyrë që të kuptohen sa më lehtë nga të gjithë. Dizajni i materialit, do të jetë pjesë e identitetit pamor për t'u identifikuar më lehtë nëpërmjet gjuhës, përdorimit të sloganit dhe logos.

Për të gjitha prodhimet e TV dhe radio spoteve, do të jetë vetëm një tingull.

○ **Fleksibiliteti dhe evoluimi i vazhdueshëm**

Vazhdimisht, duhet përcjellë, shqyrtuar dhe analizuar ecuritë - rrjedhat dhe efektet e fushatës të cilat, duhet t'iu përshtaten rrethanave konkrete.

Nuk duhet të ketë boshllëqe mes shpërndarjes dhe nevojës operacionale për informim.

○ **Parimi i paanshmërisë**

Procesi i informimit publik, duhet të jetë i pa-anshëm dhe pa ndikime politike apo partiake.

Përmbajtja e materialeve të informimit publik, synon që t'i informoj dhe motivoj votuesit të cilët marrin pjesë në zgjedhje, dhe nuk favorizon ndonjë subjekt politik që garon në zgjedhje.

○ **Parimi i koordinimit**

Qasja gjithëpërfshirëse, kërkon një koordinim të mirë dhe bashkëveprim të SKQZ-së, ndërmjet departamenteve dhe institucioneve brenda, dhe jashtë vendit.

Qasja e Informimit Publik

Fushata e Informimit Publik, do të dizajnohet dhe zbatohet për të mbështetur veprimtaritë e KQZ-së, të përcaktuara në ligj. Gjithashtu fushata do të vejë theksin mbi procesin zgjedhor, të drejtat e votuesit, rëndësinë e pjesëmarrjes, dhe rolin e KQZ-së, si institucion shtetëror me mandat kushtetues.

Të gjitha materialet elektronike dhe ato të shtypura, si për nga përmbajtja po ashtu, edhe për nga dizajni, do të identifikohen lehtë nga të gjitha kategoritë e votuesve. Përmbajtja e sloganit dhe materialeve të tjera reklamuese, qoftë në media të shkruara apo qoftë në ato elektronike, duhet të jenë lehtë të identifikueshme dhe akceptuese për të gjitha grup moshat e votuesve.

Grupet e Synuara

Strategjia synon të përfshijë të gjithë qytetarët me të drejtë vote pa asnjë dallim. Gjatë realizimit të periudhave të informimit të votuesve, do t'iu kushtohet vëmendje e veçantë kategorive dhe grupeve të veçanta të shoqërisë, duke synuar të jetë një fushatë gjithëpërfshirëse dhe informimi të arrihet te secili votues.

Fushata e informimit publik do të fokusohet të këto grupe të synuara:

- Të gjithë votuesit;
- Të Rinjtë;
- Femrat;
- Votuesit jashtë Kosovës;
- Votuesit në moshë të shtyrë;
- Votuesit me nevoja dhe rrethana të veçanta; dhe
- Votuesit e komuniteteve jo shumicë.

○ Të gjithë votuesit

Synohet informimi i të gjithë votuesve (pavarësisht nga mosha, gjinia, vendbanimi - brenda dhe jashtë Kosovës, si dhe nacionaliteti), për të gjithë procesin zgjedhor: mbi të drejtat e votimit, rëndësinë e votës, mënyrën e votimit, kohën dhe vendvotimin dhe informatat të tjera. Kjo, do të arrihet përmes përdorimit të të gjitha mjeteve të komunikimit në dispozicion.

○ Të rinjtë

Siç dihet, pjesa më e madhe e votuesve është kryesisht e re. Kjo kategori e shoqërisë, duhet të jetë më e informuar për rëndësinë e votës, dhe të jetë e gatshme të zgjedh përfaqësuesit e tyre përmes pjesëmarrjes në zgjedhje. Të rinjtë që votojnë për herë të parë do t'u shpërndahen kartolina në adresat e tyre personale. Do të realizohen mesazhe

motivuese për pjesëmarrjen e tyre në zgjedhje, të cilat do të shpërndahen përmes mjeteve të komunikimit të cilat ata i përdorin më së shumti.

- **Femrat**

Meqenëse gjysma e popullsisë janë femra, rritja e pjesëmarrjes së tyre në votim luan rol të madh në rezultatet e përgjithshme të zgjedhjeve. Përveç informimit të përgjithshëm, do të shpërndahen produktet e IP-së përmes shoqatave të ndryshme që i mbrojnë dhe përfaqësojnë interesat e tyre.

- **Votuesit jashtë Kosovës**

Për Votuesit të cilët përkohësisht banojnë jashtë Kosovës, pavarësisht nga vendbanimi i tyre, do t'i informojmë për procedurat e votimit përmes postes. Informimi do të bëhet për mënyrën e aplikimit si votues jashtë Kosovës, plotësimin e kriterëve dhe mënyrën e dërgimit të votës së tyre në kohën dhe adresën e duhur. Informimi do të bëhet përmes kanaleve të komunikimit zyrtarë përmes ambasadave, konsullatave dhe shoqatave të ndryshme të mërgimtareve, mjeteve të komunikimit që mund të jenë të qasshme prej tyre dhe përmes e-mail adresave të tyre që i kemi në dispozicion.

- **Votuesit me nevoja dhe rrethana të veçanta**

Këto kategori të votuesve, kanë nevoja për informim të veçantë, varësisht nga aftësitë e tyre dhe kushteve e rrethanave në të cilët ata/ato jetojnë. Është e rëndësishme që të sigurohemi se këta votues janë në dijeni për mundësitë e tyre për të votuar, pavarësisht aftësive dhe rrethanave të tyre. Kjo mund të bëhet përmes fushatave mediale dhe bashkëpunimit me shoqatat e ndryshme përfaqësuese të interesave të këtyre votuesve ose ata mekanizma që mbështesin çështjet e tyre, për t'iu mundësuar atyre dhënien e këshillave dhe ndihmës për mundësin e votimit.

- **Votuesit në moshë të shtyrë**

Kjo kategori e votuesve kanë nevojë për informim përmes mjeteve tradicionale të informimit siç janë televizionet dhe radiot. Andaj për informimin e tyre të gjitha informatat e procesit zgjedhor do të transmetohen në televizione dhe radio.

- **Votuesit e komuniteteve jo shumicë**

Strategjia e Informimit Publik, do t'i mbulojë të gjitha hapësirat e komuniteteve jo shumicë që jetojnë në Kosovë përmes medimeve që transmetohen në vendbanimet e tyre. Të gjitha produktet do të realizohen në gjuhën e tyre.

Produktet për Informim Publik

Për të arritur informimin të secila kategori e votuesve, do të përdoren lloje të ndryshme të produkteve, për t'i informuar të gjithë qytetaret për procesin zgjedhor dhe kjo do të bëhet në gjuhën e tyre.

- **Tingulli i zgjedhjeve**

Do të kompozohet dhe realizohet një tingull i zgjedhjeve i cili synohet të jetë reprezentues me misionin e KQZ-së. Tingulli duhet të ketë një ritëm dhe melodi origjinale dhe që tregon domethënien dhe misionin e zgjedhjeve. Tingulli i zgjedhjeve do të miratohet nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Me tingullin e zgjedhjeve do të realizohen të gjitha videot dhe radio spotet.

- **Logoja dhe Slogani i fushatës të Informimit Publik**

Logoja dhe slogani do t'i japin fushatës një pamje të përbashkët dhe identifikuese.

Si logo e fushatës së informimit publik do të përdoret logoja e KQZ-së, pasi që njihet lehtë nga votuesit dhe palët e interesit. Slogani duhet të identifikohet me zgjedhjet që organizohen. Logoja e KQZ-së do të jetë afër sloganit të Zgjedhjeve e cila do të aprovohet nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Të gjitha produktet që realizohen për procesin zgjedhor do të përmbajnë logon dhe sloganin e fushatës së informimit publik.

- **Video animacionet**

Për të gjitha periudhat e procesit zgjedhor do të realizohen video animacione të cilat janë vlerësuar më atraktive dhe më lehtë të kuptueshme për votuesit.

- **Video spotet**

Realizimi i video spotit "Si të plotësohet fletëvotimi" me Kryetaren e KQZ-së, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Kosovës 2019, është vlerësuar se e bënë fushatën të duket më serioze⁴, më të besueshme dhe njëkohësisht më të saktë në transmetimin e informacionit. Andaj video spoti për mënyrën e plotësimit të fletëvotimit, do të realizohet me Kryetaren e KQZ-së.

Preferohet që videot të realizohen nga vetë pjesëtarët e KQZ-së.

- **Video mesazhe**

Gjatë fushatës së informimit publik do të realizohet një video mesazh drejtuar të gjithë votuesve për të shfrytëzuar të drejtën e votimit. Mesazhi do të përcillet nga Kryetarja e KQZ-së.

Në të gjitha video animacionet, video spotet dhe video mesazhet e realizuara do të përdoret edhe gjuha e shenjave.

⁴ <https://www.kqz-ks.org/wp-content/uploads/2020/09/Analiz%C3%AB-e-Efektivitetit-t%C3%AB-Fushat%C3%ABs-s%C3%AB-Informimit-Publik.pdf>

- **Radio spotet**

Do të realizohen radio spote me informata për secilën periudhë të procesit zgjedhor.

- **Posterat**

Posterat do të vendosen në të gjitha qendrat e votimit, me përmbajtjen e informatave për mënyrën e votimit, dokumentet e nevojshme të identifikimit, orarin e hapjes dhe të mbylljes së qendrave të votimit, asistimi i votuesve me nevoja të veçanta dhe informimin e votuesve për mënyrën e votimit me masat mbrojtëse nga COVID -19.

- **Fletushkat**

Për detyrat dhe përgjegjësit e vëzhguesve gjatë procesit zgjedhor do të prodhohen fletushka dhe do t'u shpërndahen të gjithë vëzhguesve të akredituar.

- **Kartolinat për votuesit që votojnë për herë të parë**

Strategjia e informimit publik si fokus të veçantë ka informimin e kategorisë së votuesve që votojnë për herë të parë. Andaj për këta votues do të shpërndahen kartolina në adresat e tyre personale për t'i informuar dhe inkurajuar për të votuar.

Mjetet e Komunikimit

Për shpërndarjen e mesazheve dhe informatave për periudhat e procesit zgjedhore, për të arritur mbulueshmëri të plotë për të gjitha kategoritë e votuesve dhe në gjuhët e tyre, do të përdoren një numër i madh i mjeteve të komunikimit si në vijim:

- **Televizionet**

Mjeti kryesor i komunikimit me votuesit, do të jenë televizionet. Andaj të gjitha produktet e informimit publik, për të gjitha periudhat e procesit zgjedhor do të transmetohen përmes Radio Televizionit të Kosovës (RTK), në dy televizione nacionale, një televizion lokal me mbulueshmëri në katër komunat e veriut, ku do të informohen të gjithë votuesit në mënyrë të barabartë. Video animacionet dhe video spotet do të transmetohen në terminet më të shikuara, ndërsa për mënyrën e plotësimit të fletëvotimit në ditët sa më afër zgjedhjeve do të ketë transmetime më të shpeshta.

- **Radiot**

Radiot do të përdoren si mjet i komunikimit me votuesit për të shpërndarë informata për të gjitha periudhat e procesit zgjedhor. Radio spotet e realizuara do të transmetohen në radiot nacionale dhe në një radio lokale me mbulueshmëri në katër komunat e veriut.

- **Ueb faqja e KQZ-së**

Në Ueb faqen e KQZ-së do të vendosen të gjitha materialet e nevojshme për të gjitha periudhat zgjedhore. Materialet për informim publik që do t'i ofrohen votuesve dhe

palëve të interesit në tërësi, në mënyrë që të kenë mundësi që materialet me interes zgjedhor për ta, t'i shkarkojnë nga ueb-faqja. Materialet e vendosura do të përfshijnë: materialet në forme tekstuale, vizuale dhe ato audio.

- **Rrjetet Sociale**

Rrjetet sociale (Facebook-u, Instagrami, Twitteri dhe Youtube) janë një mjet i fuqishëm i komunikimit, në shpërndarjen e informacioneve, të cilat çdo ditë e me tepër po gjejnë përdorim tek qytetaret e të gjitha moshave. Përmes përdorimit të tyre KQZ-ja, do t'i informoj votuesit dhe palët e interesit, në mënyrë të rregullt dhe në kohë reale për procesin zgjedhor. Për të arritur mbulueshmëri sa më të lartë, të gjitha produktet e informimit do të sponsorizohen në rrjetet sociale. Në rrjetet sociale do të publikohen materiale informuese në formë të videove, fotografive dhe teksteve me informata të ndryshme.

- **Portalet e lajmeve**

Do të përdoren shtatë portale të ndryshme të lajmeve, ku do të publikohen informata për të gjitha periudhat e procesit zgjedhor. Në mesin e portaleve do të jetë edhe www.rtklive.com si dhe dy portale të komuniteteve jo shumicë.

- **Pjesëmarrja në programe televizive dhe radio**

Kryetarja e KQZ-së, Kryeshefi i SKQZ-së apo zëdhënësi i KQZ-së do të marrin pjesë në programe të ndryshme televizive dhe të radiove, për të informuar votuesit për procesin zgjedhor.

- **Pjesëmarrja në programe televizive dhe radio lokale**

Me qëllim të arritjes së informimit të çdo votues, Zëdhënësi i KQZ-së dhe Zyrtaret Komunal të Zgjedhjeve do të marrin pjesë në programe të ndryshme të televizioneve dhe radiove lokale, përmes së cilës synohet informimi i votuesve për të gjitha aktivitetet e periudhave të procesit zgjedhor.

- **Konferenca për media**

KQZ për secilën periudhë të procesit zgjedhor do të organizojë konferencë për media. Në ditën e fillimit të secilës periudhë do të mbahen konferenca për media ku publiku do të njoftohet për të gjitha aktivitetet që ndërmerren brenda periudhave të caktuara.

- **Komunikimi përmes “telefonit të hapur” pa pagesë dhe “postës elektronike”**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, gjatë gjithë procesit zgjedhor, do t'u përgjigjet të gjitha pyetjeve të mundshme nga votuesit dhe palët e interesit përmes telefonit pa pagesë dhe postës elektronike. Gjithashtu të gjithë votuesve që aplikojnë për të votuar me postë, do të shpërndaj përmes postës elektronike informacionet relevante.

Periudhat e Procesit Zgjedhor

Në këtë strategji janë përfshirë të gjitha mesazhet relevante të informimit për të gjitha periudhat e procesit zgjedhor, ashtu siç e ka përcaktuar Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme:

Certifikimi i Subjekteve Politike dhe Akreditimi i Vëzhguesve

Në këtë periudhë zgjedhore, subjektet politike informohen rreth afateve kohore për certifikim të subjekteve politike dhe të kandidatëve, si dhe akreditimit të vëzhguesve.

Subjektet politike, kandidatët dhe vëzhguesit do të informohen në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe me kohë për procesin zgjedhor në përgjithësi.

Shërbimi Votues për Ndërrimin e Qendrës së Votimit

Votuesit në këtë periudhë, informohen lidhur me se:

- Kush ka të drejtë të votoj;
- Ku duhet të votoj;
- Si ta ndërroj Qendrën e Votimit; dhe
- Për afatet kohore të regjistrimit.

Regjistrimi i Personave me Nevoja dhe Rrethana të Veçanta për Votim

Në këtë periudhë, votuesit e kësaj kategorie informohen lidhur me:

- Regjistrimin si votues me nevoja dhe rrethana të veçanta për votim;
- Mënyrën e regjistrimit;
- Dokumentet e nevojshme për regjistrim; dhe
- Afatet kohore për regjistrim.

Konfirmimi dhe Kundërshtimi i Listës Votuese

Votuesit në këtë periudhë informohen lidhur me:

- Publikimin e listës votuese;
- Verifikimin e përfshirjes në listën votuese;
- Mundësin e korrigjimit të çfarëdo lëshimi apo pasaktësie; dhe
- Afatet kohore për konfirmim dhe kundërshtim.

Plotësimi i Fletëvotimit

Në këtë periudhë, votuesit informohen për:

- Mënyrën e plotësimit të fletëvotimit;
- Dokumentet e vlefshme të identifikimit; dhe
- Orarin e hapjes dhe të mbylljes së qendrave të votimit.

Regjistrimi për Votim Jashtë Kosovës

Votuesit në këtë periudhë informohen për:

- Aplikimin për regjistrim për të votuar përmes postës;
- Vendin ku mund të gjendet formulari;
- Përbushjen e obligimeve për votim përmes postës;
- Adresat për dorëzim të aplikacionit; dhe
- Afatet kohore të aplikimit për regjistrim për votim përmes postës.

Votimi Jashtë Kosovës

Votuesit me vendbanim jashtë Kosovës në këtë periudhë do të informohen për:

- Procedurat e votimit;
- Vendin ku mund të gjendet fletëvotimi;
- Plotësimin e fletëvotimit;
- Kopjen e dokumentit identifikues që duhet të jetë në pakon e fletëvotimit;
- Kush për kënd mund të dorëzoj fletëvotimin përmes postës;
- Adresat për dorëzim të pakos së fletëvotimit; dhe
- Afatin e pranimit të fletëvotimeve.

Informata të tjera të nevojshme për këtë proces zgjedhor

Informimi publik nuk do të kufizohet vetëm në ato informata që ipën për secilën periudhë të procesit zgjedhor, por edhe informata tjera të nevojshme, si në vijim:

Informimi për masat mbrojtëse nga COVID - 19

Votuesit informohen për:

- Mënyrën e votimit me masat mbrojtëse nga COVID -19; dhe
- Mënyrën e votimit për votuesit të infektuar me COVID -19 dhe ata në vetizolim.

Informimi për asistimin e votuesve me nevoja të veçanta dhe mënyrat e denoncimit

Votuesit dot të informohen për:

- Mundësin e asistimit të votuesve me nevoja të veçanta; dhe
- Mënyrat e denoncimit të keqpërdorimit të votës.

Për t'i shpërndarë këto informacione do të realizohen: njoftime, video animacione, video spote, radio spote, postera, kartolina dhe mesazhe të ndryshme.

Produktet, përveç transmetimit në televizione, radio, ueb faqe dhe rrjetet sociale të KQZ-së, portale të lajmeve do të distribuohen edhe përmes palëve të interesit dhe mekanizmave të tjerë, në mënyrë që të arrihen sa më shumë votues.

Bashkëpunimi me Palët e Interesit

KQZ-ja do të bashkëpunojë me të gjitha palët e interesit. Përveç dhënies së informatave të rregullta dhe sipas kërkesës, KQZ-ja do të bashkëpunojë me palët e interesit me qëllim të pranimit të ideve dhe sugjerimeve të tyre në përmirësimin e procesit dhe mënyrës së informimit të votuesve. Kjo do të bëhet përmes shkresave dhe formave të ndryshme të komunikimit.

Bashkëpunimi i KQZ-së me Organizatat e Shoqërisë Civile

Organizatat e shoqërisë civile, kanë një rol të rëndësishëm në nxitjen e pjesëmarrjes në zgjedhje.

KQZ-ja i mirëpret dhe bashkëpunon me të gjitha OSHC-të, të cilat realizojnë aktivitete për informimin dhe edukimin e votuesve me theks të veçantë, votuesit e rinj, gjininë femërore, votuesit me nevoja dhe rrethana të veçanta si dhe votuesit e komuniteteve jo shumicë, për t'iu ofruar votuesve informacionet e duhura për ta ushtruar të drejtën e votimit. Bashkëpunimi do të synohet së paku përmes këtyre organizatave: KDI, D4D, Democracy Plus, YIHR, INPO, VoRAE, Ngo Aktiv, Germin, Rrjetit të grave të Kosovës, shoqata Handikos, shoqata e të Verbërve, shoqata e të Shurdhërve, shoqata Dawn Syndrome, etj.

Bashkëpunimi i KQZ-së me Institucionet

Informimi dhe edukimi i votuesve do të ndihmohet dhe do të mirëpritet përmes bashkëpunimit të: Mediave, Kryetarëve të Komunave, Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Ambasadave dhe Konsullatave, PZAP-së, Shoqatave dhe Klubeve të Mërgimtarëve, Komisionit të Pavarur të Mediave dhe Subjekteve politike.

Struktura e Menaxhimit dhe Mënyrat e Zbatimit

KQZ-ja do të caktoj një këshill mbikëqyrës për shqyrtimin dhe miratimin e produkteve të informimit publik, i cili do t'i raportoje KQZ-së, rregullisht mbi ecurinë e zbatimit të Strategjisë së Informimit Publik.

Për zbatimin e kësaj strategjie do të ketë bashkëpunim me një numër të akterve të ndryshëm: institucione të ndryshme, OSHC që merren me kategori të caktuara të qytetarëve, si dhe disa aktivitete dhe produkte do të realizohen përmes operatorit ekonomik.

Kjo Strategjia do të realizohet në bashkëpunim të drejtpërdrejt me Këshillin Mbikëqyrës të Informimit Publik, Divizionin për Informim dhe Edukim të Votuesve, Menaxherin e kontratës, Komisionin për verifikimin e sasive të produkteve të IP-së, Zyrtaret e Lartë komunal të Zgjedhjeve, Operatorin ekonomik dhe Palët e interesit.

Të gjitha aktivitetet për periudhat e procesit zgjedhor, do të realizohen sipas Planit Operacional për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës më 14 shkurt 2021, i cili do të miratohet nga KQZ.

Buxheti për Realizimin e Strategjisë

Buxheti për realizimin e aktiviteteve të parapara në këtë strategji do të sigurohet nga buxheti i përgjithshëm i shtetit të Republikës së Kosovës, dhe nga donacionet e ndryshme sipas gatishmërisë së donatorëve për të financuar ndonjë aktivitet të kësaj strategjie.

Shtojca nr. 1. Plani i veprimit për zbatimin e strategjisë së IP-së

Aktivitetet e informimit publik për periudhat e procesit zgjedhor

Për zbatimin e strategjisë së informimit publik për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës më 14 shkurt 2021, do të ndërmerren një numër i caktuar i aktiviteteve, për secilën nga periudhat e procesit zgjedhor.

Certifikimi i subjekteve politike dhe akreditimi i vëzhguesve

Në këtë periudhë zgjedhore, subjektet politike informohen rreth afateve kohore për certifikim të subjekteve politike dhe të kandidatëve, si dhe akreditimit të vëzhguesve.

Subjektet politike, kandidatët dhe vëzhguesit do të informohen në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe me kohë për procesin zgjedhor në përgjithësi.

Kjo do të realizohet përmes njoftimeve, video animacioneve dhe fletushkave në gjuhët dhe mënyrën e shpërndarjes së tyre sipas tabelës në vijim.

Tabela nr. 1. Aktivitetet për periudhën e certifikimit të subjekteve politike dhe akreditimin e vëzhguesve

Produktet/sasitë	Gjuhët	Mënyra/kanalet e shpërndarjes
Një njoftim	- Shqipe - Serbe	- Ueb-faqja e KQZ-së - Rrjetet sociale të KQZ-së
Një video animacion	- Shqipe - Serbe	- RTK1, RTK2, RTK3 - Ueb-faqja e KQZ-së - Rrjetet sociale të KQZ-së (4 sponsorizime) - Rrjetet sociale të OJQ-ve - Portali www.rtklive.com - Gjashtë portale të lajmeve (nga 1 sponsorizim në secilin portal)
40,000 fletushka	- Shqipe - Serbe	- ZRPPC

Shërbimi Votues për Ndërrimin e Qendrës së Votimit

Votuesit në këtë periudhë, informohen lidhur me atë se:

- Kush ka të drejtë të votoj;
- Ku duhet të votoj;
- Si ta ndërroj Qendrën e Votimit; dhe
- Për afatet kohore të regjistrimit.

Këto do të realizohen përmes njoftimeve, video animacioneve, radio spoteve dhe posterve, mënyrën e shpërndarjes së tyre dhe në gjuhët sipas tabelës në vijim.

Tabela nr. 2. Aktivitetet për periudhën e shërbimit votuese për ndërrimin e qendrës së votimit.

Produktet/sasitë	Gjuhët	Mënyra/kanalet e shpërndarjes
Një njoftim	- Shqipe - Serbe	- Ueb-faqja e KQZ-së
Një video animacion	- Shqipe - Serbe - Boshnjake - Turke - Rome	- RTK1, RTK2, RTK3 - Dy televizione nacionale - Një televizion lokal për komunitetin serb - Ueb-faqja e KQZ-së - Rrjetet sociale të KQZ-së (12 sponsorizime) - Rrjetet sociale të OJQ-ve - Rrjetet sociale të komunave - Portali www.rtklive.com - Gjashtë portale të lajmeve (nga 1 sponsorizim në secilin portal)
Një radio spot	- Shqipe - Serbe - Boshnjake - Turke - Rome	- Radio Kosova1 - Radio Kosova2 - Dy radio nacionale - Një Radio lokale për komunitetin serb
Dy njoftime	- Shqipe - Serbe - Boshnjake - Turke - Rome	- Rrjetet sociale të KQZ-së (12 sponsorizim) - Rrjetet sociale të OJQ-ve - Rrjetet sociale të komunave - Portali www.rtklive.com
Një poster	- Shqipe - Serbe - Boshnjake - Turke - Rome	- Ueb-faqja e KQZ-së - Ueb-faqet e komunave - Rrjetet sociale të KQZ-së (7 sponsorizime) - Rrjetet sociale të OJQ-ve - Rrjetet sociale të komunave
Një baner	- Shqipe - Serbe - Turke	- Gjashtë portale të lajmeve

Regjistrimi i Personave me Nevoja dhe rrethana të Veçanta për Votim

Në këtë periudhë, votuesit e kësaj kategorie informohen lidhur me:

- Regjistrimin si votues me nevoja dhe rrethana të veçanta për votim;
- Mënyrën e regjistrimit;
- Dokumentet e nevojshme për regjistrim; dhe
- Afatet kohore për regjistrim.

